

NJOFTIM
Nr. 5848/1, datë 13.7.2026

**PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË
INSTITUTIT TË PËRGATITJES SË QENVE TË POLICISË, TIRANË**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet, apo transformohet, dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, kapitulli III, shpallen për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:

1. Në administrim të Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë, Tiranë

Nr.	Emërtimi	Datëlindja	Vendndodhja	Vlera fillestare e ankandit në lekë	Zhvillimi i ankandit		
					Data	Ora	Vendi
1	Qeni Dasti	11.8.2016	Tiranë	5,000	14.8.2026	10:00	DSHPP
2	Qeni Dea	3.6.2024	Tiranë	5,000	14.8.2026	11:00	DSHPP

Çdo person fizik, apo juridik, i interesuar për blerje, duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerje e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit

2. Garancinë bankare, apo mandatpagesën, në origjinal, që vërteton ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë, për llogari të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit.

3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën shpallur për shitje, i konfiskohet 20% e garancisë bankare, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Garancia bankare, apo mandatpagesa, duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Garancia bankare, apo mandatpagesa, mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, pasi të keni tërhequr pranë DSHPP-së faturën për arkëtim, të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit. Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit: www.ekonomia.gov.al.